

HULUMTIM i opinionit PUBLIK



PRAKTIKAT DHE PERCEPTIMET E QYTETARËVE NË DREJTIM TË informimit trajtimit të dhe dezinformatave

Institute of Communication Studies

Institute of Communication Studies

respublica

Hulumtim i opinionit publik

Praktikat dhe perceptimet e qytetarëve në drejtim të informimit dhe trajtimit të dezinformatave

mars 2025

Përmbajtja

Metodologjia 4
Hyrje 5
Burimet e informimit dhe temat me interes 7
Perceptimet dhe qëndrimet rreth raportimit të mediave 10
Vetëperceptimi i qytetarëve për aftësinë e tyre për të njohur dhe për mbrojtje nga dezinformatat 12
Perceptimet në lidhje me mënyrën e komunikimit të institucioneve shtetërore me publikun 18
Krahasimi i përgjigjeve me hulumtimet e mëparshme 38
Aneksi 1: Karakteristikat socio-demografike të të anketuarve 40
Aneks 2: Pyetësori i anketës 40

Metodologjia

Numri i pyetjeve: 14

Mostra: N=1000 (të anketuar të moshës mbi 18 vjeç në të gjithë territorin e vendit)

Periudha: 5-25 shkurt 2025

Gabim statistikor: ± 3%

Hyrje

Në kuadër të këtij raporti janë prezantuar gjetjet e një hulumtimi të opinionit publik mbi praktikat dhe perceptimet e qytetarëve në drejtim të informimit dhe trajtimit të dezinformatave. Ky hulumtim synon të shqyrtojë se si qytetarët marrin informacione, për cilat tema janë më të interesuar, si e perceptojnë raportimin e mediave, pikëpamjet e tyre mbi transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve shtetërore, si dhe strategjitë e tyre për trajtimin e dezinformatave. Hulumtimi është pjesë e projektit "Përdor fakte" të zbatuar nga Instituti për Studime të Komunikimit në periudhën nga viti 2022 - 2025, me mbështetje të Ambasadës Britanike në Shkup. Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe rezistencën e publikut, veçanërisht të kategorive të rrezikuara në Maqedoninë e Veriut, ndaj dezinformatave.

Ky është hulumtimi i katërt i kryer në kuadër të projektit, duke lejuar analizë krahasuese të rezultateve në fusha të caktuara. Sondazhi u krye në një mostër përfaqësuese prej 1.000 qytetarë të rritur nga rajone të ndryshme në të gjithë vendin, ndërsa realizues i sondazhit është Instituti për Demokraci "Societas Civilis". Të dhënat u mblodhën përmes një sondazhi telefonik nga 5 deri më 25 shkurt 2025. Është e rëndësishme të theksohet se në disa nga pyetjet subjektet patën mundësinë të zgjidhnin më shumë se një përgjigje, e cila rezultoi në shumën e përqindjeve për disa pyetje të caktuara që tejkalonte 100%.

Sondazhi tregon se 51% e qytetarëve në Maqedoninë e Veriut informohen disa herë gjatë ditës, ndërsa 27% e bëjnë këtë një herë në ditë, gjë që sugjeron në përfundimin se një përqindje e lartë e të anketuarve informohen çdo ditë për tema të ndryshme. Televizioni, mediat sociale dhe portalet online mbeten burimet më të zakonshme të informimit, ndërsa më pak se 10% mbështeten në kontaktet personale për të marrë lajme.

Temat me interes më të madh për të anketuarit janë shëndetësia, financat publike, arsimi, shkenca dhe teknologjia. Sa i përket cilësisë së përmbajtjes mediatike, 74% e të anketuarve ndajnë mendimin se media përcjell vetëm informacione themelore ose sipërfaqësore, pa analizë përkatëse.

Perceptimi për besueshmërisë së mediave është i ndarë: 29% e qytetarëve vënë në dyshim gjithçka që publikohet, e njëjta përqindje kontrollon të njëjtin lajm në media të tjera përkatëse, ndërsa 21% besojnë se nëse diçka publikohet, atëherë është e vërtetë. Shumë pak kontrollojnë se kush e ka dhënë lajmin (8%) ose konsultohen me ekspertë (7%). Për më tepër, në përgjigjet e pyetjes shtesë u konstatua se 80% e të anketuarve rrallë ose aspak nuk kontrollojnë autorin e lajmit, ndërsa 71% rrallë ose aspak nuk kontrollojnë publikuesin.

Sa i përket aftësisë për të njohur dezinformatat, 41% besojnë se ndonjëherë kanë sukses, 29% besojnë se gjithmonë mund të zbulojnë vërtetësinë e informacionit, ndërsa 11% pranojnë se nuk mund të dallojnë aspak informacionin e rremë nga ai i vërtetë.

Sa i përket burimeve të dezinformatave, 36% e të anketuarve besojnë se par-

titë politike janë burimi kryesor i përhapjes së dezinformatave, 12% theksojnë fushën mediatike ndërsa 4% institucionet shtetërore.

Këto gjetje tregojnë se qytetarët kryesisht përdorin mediat digjitale dhe tradicionale për informim, por kanë besim të ulët në saktësinë e informacionit të publikuar dhe rrallë marrin masa për ta verifikuar atë.

Dallimet statistikisht të rëndësishme për sa i përket karakteristikave socio-demografike të të anketuarve u shfaqën kryesisht për sa i përket moshës dhe përkatësisë etnike të të anketuarve, për sa i përket një numri të vogël pyetjesh, kryesisht në lidhje me burimet e informimit dhe fushave në të cilat të anketuarit janë të interesuar. Për shkak të numrit të vogël të përgjigjeve në blloqe të caktuara pyetjesh (në seksionin Perceptimet në lidhje me mënyrën e komunikimit të institucioneve shtetërore), nuk ishte e mundur të analizoheshin dallimet në perceptime dhe qëndrime duke pasur parasysh karakteristikat socio-demografike të të anketuarve.


Burimet e informimit dhe temat me interes

Blloku i parë i pyetjeve kishte për qëllim identifikimin se sa shpesh qytetarët informohen në lidhje me temat me interesit të tyre, burimet më të zakonshme të informimit që ata përdorin dhe fushat që qytetarët më shpesh preferojnë të ndjekin.

Në kuadër të pyetjes së parë, të anketuarve iu kërkua të përgjigjen se sa shpesh informohen për zhvillimet në vend dhe në botë, me shpeshtësinë e informimit që varionte nga disa herë në ditë deri në asnjëherë.


Shumica e të anketuarve (51%) informohen disa herë gjatë ditës për zhvillimet në vend dhe në botë, ndërsa më pak se një e treta (27%) informohen në mënyrë aktive një herë në ditë. Përqindje pak më e vogël (17%) e të anketuarve informohen disa herë gjatë javës, ndërsa 5% nuk tregojnë aspak interes për zhvillimet shoqërore. Sa i përket karakteristikave socio-demografike të të anketuarve, dallimet statistikisht të rëndësishme u shfaqën vetëm për sa i përket moshës, me të moshuarit prej 55 në 64 vjeç (61%) dhe pensionistët (69%) që praktikojnë të informohen disa herë në ditë, ndërsa midis grup moshave më të reja kjo përqindje varion rreth 40%.

Grafiku 1. Frekuenca e informimit, në përqindje.



Në pyetjen se ku kanë marrë më shpesh informacione për zhvillimet në vend dhe në botë, të anketuarve iu dha mundësia të citojnë deri në tre burime informimi. Kështu, sipas përgjigjeve, **pothuajse dy të tretat e të anketuarve përmendin televizionin (72%), pastaj mediat sociale (55%) dhe portalet online (38%) si një nga burimet e informimit.** Vetëm 9% e të anketuarve marrin informacion të ri nga mjedisi shoqëror, përkatësisht nga kolegët, miqtë dhe të afërmit. Për sa i përket dallimeve sipas karakteristikave socio-demografike të të anketuarve, dallime të rëndësishme u shfaqën për sa i përket gjinisë, me gratë (76%) më shpesh se burrat (67%) që përdorin programet televizive si burim informimi, ndërsa burrat (43%) më shpesh përdorin mediat online krahasuar me gratë (32%). Ajo që është e pritshme është që mediat sociale mbeten burimi kryesor i informimit për qytetarët më të rinj (38%), nga 25 në 34 (36%), dhe midis qytetarëve nga 35 në 44 vjeç (37%), ndërsa midis qytetarëve të moshuar pothuajse gjysma e të anketuarve (45.8%) më së shpeshti përdorin kanalet televizive si burimi kryesor të informimit.


Grafiku 2. Burimet më të zakonshme të informimit, në përqindje (zgjedhje e shumëfishtë).



Në pyetjen se cilat tema i tangojnë ose interesojnë më shumë qytetarët, **shëndetësia dhe zhvillimet në sektorin e shëndetësisë janë më të rëndësishme për një numër shumë më të madh të qytetarëve (38%) sesa zhvillimet që lidhen me financat publike (19%), arsimin, shkencën dhe teknologjinë (14%) dhe çështjet**

rreth mjedisit dhe planifikimit hapësinor (13%). Disi më pak të rëndësishme për qytetarët janë temat që lidhen me bujqësinë (9%) dhe çështjet lokale (5%). Për sa i përket dallimeve në karakteristikat socio-demografike të të anketuarve, pothuajse gjysma e të anketuarve (47%) sugjerojnë shëndetin dhe shëndetësinë si temën më të rëndësishme për informim, pasuar nga zhvillimet në arsim dhe shkencë (17%). Në mesin e burrave, midis të cilëve përgjigjet janë përgjithësisht më të fragmentuara, interesi kryesor është shëndetësia (30%), financat publike (24%), mjedisi (15%) dhe bujqësia (12%). Për sa i përket moshës, grupi më i ri i qytetarëve të moshës 18-24 vjeç janë më të interesuar në temat që lidhen me arsimin, shkencën dhe zhvillimin teknologjik (28%) dhe në sektorin e shëndetësisë (27%), ndërsa informacionet në lidhje me financat publike janë më tërheqëse për qytetarët e moshës 35-44 vjeç (27%). Qytetarët e rritur nga 55 deri në 64 vjeç (46%) dhe shumica e pensionistëve (57%) janë më të interesuar në temat që lidhen me shëndetësinë dhe sektorin e shëndetësisë. Për sa i përket përkatësisë etnike, maqedonasit etnikë (46%) dhe komunitetet më të vogla etnike (46%) janë më të interesuar për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor. Shqiptarët ndërkohë, në një masë më të madhe (27%) nga grupet e tjera etnike tregojnë interes më të madh për rrjedhat në financat publike, pensionet dhe ekonominë informale sesa maqedonasit etnikë (17%) dhe komunitetet më të vogla etnike (12%).

Grafiku 3. Interesi për informacione nga fusha të veçanta, në përqindje.




Perceptimet dhe qëndrimet rreth raportimit të mediave

Blloku i dytë i pyetjeve përqendrohet në perceptimin e qytetarëve për shkallën në të cilën mediat raportojnë për temat në interes të tyre, si dhe për mënyrën në të cilën mediat e përcjellin këtë informacion.


Shumica e qytetarëve (41%) besojnë se mediat ndonjëherë publikojnë lajme që janë në interesin e tyre, 31% besojnë se mediat rregullisht dhe në kohë publikojnë informacione të hollësishme, dhe pak më pak, përkatësisht 21% besojnë se mediat rrallë informojnë për tema që janë në interesin e tyre personal. Gjashtë për qind e të anketuarve nuk mendojnë se mediat publikojnë lajme për temat që u interesojnë. Për sa i përket karakteristikave socio-demografike, dallimet statistikisht të rëndësishme u shfaqën për sa i përket përkatësisë etnike, me komunitetet më të vogla etnike që ishin shumë më të kënaqura me intensitetin e raportimit për temat që u interesonin (42%), krahasuar me maqedonasit (34%) dhe shqiptarët (18%).

Grafiku 4. Qëndrimet ndaj raportimit për tema me interes, në përqindje.



Në pyetjen se cili është perceptimi i tyre se sa thellë mediat analizojnë dhe informojnë për temat që u interesojnë në bazë të të cilave do të fitonin njohuri ose këqyrje të mjaftueshme për ngjarjet, **një shumicë e madhe e të anketuarve (74%) besojnë se mediat përcjellin vetëm informacione themelore ose sipërfaqësore për atë që raportojnë**. Në të kundërt, vetëm 26% e të anketuarve ishin të kënaqur me mënyrën se si mediat e kanë përcjellë informacionin. Nga pikëpamja etnike, përgjigjet e të anketuarve janë pothuajse të barabarta.

Grafiku 5. Perceptimet për informimin mediatik, në përqindje.




Vetëperceptimi i qytetarëve për aftësinë e tyre për të njohur dhe për mbrojtje nga dezinformatat

Blloku i tretë i pyetjeve përqendrohet në atë se si qytetarët e perceptojnë aftësinë e tyre për përballje me dezinformatat në media, mënyrat në të cilat ata kontrollojnë besueshmërinë dhe vërtetësinë e lajmeve, por edhe kë ata e theksojnë si burimin më të madh të dezinformatave në mesin e publikut në Maqedoninë e Veriut.


Pyetja e parë shqyrton mënyrat në të cilat qytetarët kontrollojnë besueshmërinë e mediave nga të cilat informohen më shpesh. Në pyetjen "Si e dini nëse mund t'i besoni mediave nga të cilat informoheni?" të anketuarit mund të zgjidhnin një nga tre përgjigjet e mundshme. Sa i përket rezultateve, **një e treta e të anketuarve (29%) vënë në dyshim gjithçka që raportojnë mediat. Një përqindje identike e qytetarëve (29%) e bazojnë besimin e tyre në informacionin e marrë duke kontrolluar se si raportohen të njëjtat lajme nga media të tjera relative. Një përqindje pak më e vogël e qytetarëve (21%) nisen nga supozimi se meqenëse publikohet një lajm, duhet të jetë i vërtetë**. **Një numër i vogël qytetarësh në procesin e marrjes së informacioneve kontrollojnë se kush e ka dhënë lajmin (8%) ose konsultohen me dikë që ka më shumë njohuri mbi temën (7%), dhe vetëm 2% kontrollojnë nëse autori i lajmit është shënuar në tekst.** Një minimum prej 4% e të anketuarve besojnë pa rezerva se gjithçka që raportohet në media është e vërtetë. Nga pikëpamja e shqiptarëve, në masë të konsiderueshme më pak besojnë se atë që lexojnë është e besueshme për shkak se është publikuar (15%), krahasuar me komunitetet më të vogla etnike (26%) dhe maqedonasit (22%).

Grafiku 6. Perceptimet dhe praktikat për kontrollimin e informacioneve nga mediat, në përqindje.




Në pyetjen se sa shpesh mund të njohin personalisht nëse një lajm është i rremë ose dezinformatë, **pak më pak se gjysma e të anketuarve (41%) besojnë se ndonjëherë kanë sukses, ndërsa një e treta e qytetarëve (29%) janë të sigurt se gjithmonë arrijnë të zbulojnë me saktësi besueshmërinë dhe të vërtetën e një lajmi të veçantë.** Pak më pak të anketuar janë të mendimit se rrallë i njohin lajmet e tilla (19%), ndërsa 11% thanë se nuk mund të bënin fare dallimin midis lajmeve të vërteta dhe të rreme ose dezinformatave. Një pjesë e madhe e maqedonasve (44%) dhe bashkësive më të vogla etnike (42%) besojnë se ndonjëherë arrijnë të bëjnë dallimin midis dezinformimit dhe lajmit të vërtetë, ndërsa përqindja e shqiptarëve që u përgjigjën njësoj është dukshëm më e ulët, pra 34%.

Grafiku 7. Aftësia për të njohur lajmet e rreme dhe dezinformatat, vetëvlerësimi, në përqindje.




Sa i përket shpeshtësisë së **shkëmbimit të informacioneve me dikë që më vonë është zbuluar se kanë qenë të pasakta, shumica e qytetarëve (52%) besojnë se ka ndodhur, por jo aq shpesh, ndërsa një 40% e lartë janë të sigurt se informacioni që ata ndajnë është gjithmonë i vërtetë.** Vetëm 8% e të anketuarve besojnë se shpesh ndodh që ata nuk i detektojnë informacionet e pasakta në kohën e duhur. Ekziston një ndryshim i rëndësishëm në vetëbesimin e të anketuarve sipas karakteristikave të caktuara socio-demografike për sa i përket aftësisë për të njohur lajmet e rreme ose dezinformatat. Konkretisht, dyshimi në aftësinë për të dalluar informacionet e rreme nga informacionet e vërteta është më i theksuar në mesin e pensionistëve, ku 19% u përgjigjën se nuk mund të njohin informacione të rreme. Për krahasim, në grupin më të ri (18-24 vjeç) kjo përqindje është vetëm 3%, ndërsa në mesin e qytetarëve nga 25 në 34 vjeç është 4%.

Grafiku 8. Frekuenca e ndarjes së lajmeve të rreme dhe dezinformatave, vetëvlerësimi, përqindja.




Qytetarët u pyetën gjithashtu se kush konsiderojnë se është burimi më i madh i dezinformatave. **Përgjigjet më të zakonshme ishin se në Maqedoninë e Veriut shumica e dezinformatave vijnë nga partitë politike (36%),** disa besojnë se janë mediat (12%), ndërsa vetëm 4% besojnë se institucionet shtetërore janë burimi i dezinformatave. Pothuajse gjysma e të anketuarve (47%) besojnë se të gjitha subjektet e përmendura më parë janë burime të shpeshta të përhapjes së dezinformatave midis qytetarëve. Qytetarët e moshës 55 deri në 64 vjeç (41%) dhe pothuajse gjysma e pensionistëve (45%) si burimin kryesor të dezinformatave në vend theksojnë partitë politike, ndërsa qytetarët e moshës 35 deri në 44 vjeç janë kryesisht (59%) të bindur se dezinformatat vijnë nga të gjitha subjektet e listuara. Shumica e qytetarëve nga komunitetet më të vogla etnike (55%) theksuan të gjitha subjektet e listuara si burime të dezinformimit. Maqedonasit në një masë disi më të vogël (48%) i renditën të gjitha këto, ndërsa vetëm 40% e shqiptarëve besojnë se dezinformimi vjen nga burime të shumta.

Grafiku 9. Burimet e dezinformimit, në përqindje.



Pyetja e fundit e këtij blloku kishte për qëllim identifikimin e hapave që të anketuarit ndërmarrin për të kontrolluar besueshmërinë e informacioneve që pranojnë. Në shumicën e rasteve, qytetarët ndërmarrin hapat e nevojshëm për të kontrolluar në një masë të pakënaqshme besueshmërinë e informacionit ose shpërndarësit të lajmeve. **Të anketuarit në pothuajse 80% të rasteve rrallë ose kurrë nuk kontrollojnë autorin e informacionit që pranojnë, ndërsa 71% rrallë ose kurrë nuk kontrollojnë as botuesin, as publikuesin e lajmit.** Sa i përket këshillimit me personat që janë më të udhëzuar në lidhje me temën ose kontrollit se si përcillet lajmi në media të tjera, megjithëse kemi një bllok mjaft të përzier përgjigjesh, gjetja mbizotëruese është se këto hapa nuk ndërmerren kurrë nga të anketuarit (35%). Grupi më i vjetër i qytetarëve (65+) krahasuar me të gjitha grupet e tjera të qytetarëve më shpesh nuk kontrollojnë kurrë se kush është autori i lajmit (70.3%), kurrë nuk konsultohen me njerëz të tjerë (47%) dhe kurrë nuk kontrollojnë se si përcillet i njëjti lajm në media të tjera (40%)

Grafiku 10. Praktikat e kontrollit të besueshmërisë së lajmeve, në përqindje.




Perceptimet në lidhje me mënyrën e komunikimit të institucioneve shtetërore me publikun

Blloku i fundit i pyetjeve përqendrohet në perceptimin e qytetarëve për hapjen për informim të institucioneve publike dhe sa të kënaqur janë me mënyrën se si dhe me çfarë intensiteti institucionet publike komunikojnë me publikun, veçanërisht për tema me interes të tyre.

Lidhur me këtë bllok pyetjesh, institucionet e përfshira rrjedhin nga përgjigjet e qytetarëve në pyetjen 3 të anketës, përkatësisht nga temat që janë me interes të veçantë për informimin e qytetarëve. Në këtë kontekst, u hulumtuan perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve në lidhje me komunikimin nga institucionet e mëposhtme: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (mjedisi dhe planifikimi urban), Ministria e Arsimit dhe Shkencës (arsimi, shkenca dhe teknologjia), Ministria e Shëndetësisë (shëndeti dhe shëndetësia), Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale (energjia, minierat dhe burimet minerale), Ministria e Financave (financat publike – borxhi publik, pensionet, ekonomia informale, mbështetja e kompanive), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (bujqësia) dhe Qyteti i Shkupit (temat lokale nga Qyteti i Shkupit). Për shkak të ndarjes së lartë të përgjigjeve (për shtatë institucione), krahasimi sipas veçorive të veçanta socio-demografike nuk ishte statistikisht i qëndrueshëm (një pjesë e madhe e opsioneve ka më pak se 50 përgjigje) dhe teksti në vijim komenton shpërndarjen e përgjithshme të përgjigjeve.


Kur bëhet fjalë për atë se sa informacionet mbi temat e mjedisit jetësor dhe planifikimit mjedisor për të cilat të interesuar të anketuarit dhe sa ato janë të disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) ose në faqet e mediave sociale, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (42.1%) kurrë nuk vizitojnë faqet e institucionit kompetent nga fusha e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Më shumë se një e treta e të anketuarve besojnë se një pjesë e vogël e informacionit për të cilin janë të interesuar është në dispozicion në faqet e MMJPH-së, ndërsa më pak se 20% besojnë se shumica ose të gjitha informacionet me interes mund të gjenden në faqet e MMJPH-së.

Grafiku 11. Përceptimet për disponueshmërinë e informacioneve në faqen e internetit dhe mediat sociale të MMJPH-së, në përqindje.




Kur bëhet fjalë për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe kënaqësinë e të anketuarve në lidhje me disponueshmërinë e përmbajtjes në lidhje mearsimin, shkencën dhe teknologjinë në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të këtij institucioni, mund të konstatohet si më poshtë: **31% e të anketuarve u përgjigjën se kurrë nuk vizitojnë faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe rrjeteve sociale të institucionit;** vetëm 4% besojnë se një informacion i tillë nuk mund të gjendet në burimet e përmendura; pak më shumë se një e katërta (27%) besojnë se një pjesë e vogël e informacionit me interes mund të gjendet në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të MASH, **ndërsa më shumë se 38% besojnë se shumica ose të gjitha informacionet në fushën e arsimit, shkencës dhe teknologjisë mund të gjenden në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të MASH.**

Grafiku 12. Përceptimet për disponueshmërinë e informacioneve në faqen e internetit dhe mediat sociale të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në përqindje.




Sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), pothuajse gjysma e të anketuarve të interesuar për temën e shëndetit nuk vizitojnë kurrë faqen e internetit të MSH-së dhe mediat sociale; rreth 4% e të anketuarve besojnë se një informacion i tillë nuk është i disponueshëm në burimet e përmendura, një e katërta (26%) besojnë se një pjesë e vogël e informacionit nga tema e interesit është në dispozicion në faqet e MSH-së, ndërsa pak më shumë se një e pesta (21.9%) besojnë se shumica ose të gjitha informacionet mund të gjenden në ueb faqet e mediave sociale të MSH-së.

Grafiku 13. Përceptimet për disponueshmërinë e informacioneve në faqen e internetit dhe mediat sociale të MSH-së, në përqindje.




Lidhur me pikëpamjet mbi informimin nga Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale (MEMBM), shumica e të anketuarve besojnë se ajo publikon një pjesë të vogël të informacioneve në këtë fushë në interesin e tyre. Më pak se një e treta (29.4%) nuk kanë vizituar kurrë faqet online të kësaj ministrie, ndërsa 29.5% besojnë se shumica ose të gjitha informacionet nga kjo fushë mund të gjenden në faqen e internetit të MEMBM-së dhe në faqet e mediave sociale. Një përqindje e lartë e të anketuarve që iu përgjigjën kësaj pyetjeje besojnë se një pjesë e vogël e informacioneve në fushën për të cilën janë të interesuar mund të gjenden në faqen e internetit të ministrisë dhe në faqet e mediave sociale.

Grafiku 14. Përceptimet për disponueshmërinë e informacioneve në faqen e internetit dhe mediat sociale të MEMBM-së, në përqindje.




Kur u pyetën për pozicionin e tyre mbi disponueshmërinë e informacionit në faqen e internetit të Ministrisë së Financave (MF) dhe mediat sociale, 37% e të anketuarve kurrë nuk i vizitojnë këto faqe për të marrë informacion, 6.4% mendojnë se një informacion i tillë nuk është i pranishëm në këto faqe, **30.7% mendojnë se një pjesë e vogël e informacionit me interes është në dispozicion në faqet e MF, ndërsa pak më shumë se një e katërta (25.9%) besojnë se shumica ose të gjitha informacionet mbi temën e interesit mund të gjenden në faqen e internetit të MF-së dhe mediat sociale.**

Grafiku 15. Përceptimet për disponueshmërinë e informacioneve në faqen e internetit dhe mediat sociale të MF-së, në përqindje.




Në drejtim të informacioneve të paraqitura në faqet online të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU), pothuajse gjysma e të anketuarve (48.9%) nuk vizitojnë kurrë faqet e këtij institucioni në kërkim të informacionit mbi temën. Një përqindje e ulët - 5.7% e të anketuarve, besojnë se një informacion i tillë nuk është i përfaqësuar në faqet dhe profilet e MBPEU. Pak më pak se një e pesta prej 18.2% besojnë se një pjesë e vogël e informacionit të kërkuar mund të gjendet në këto faqe, **ndërsa pak më shumë se një e katërta 27.2% besojnë se shumica ose të gjitha informacionet mund të gjenden në faqet e internetit të mediave sociale.**

Grafiku 16. Përceptimet për disponueshmërinë e informacioneve në faqen e internetit dhe mediat sociale të MBPEU-së, në përqindje.



Sa i përket informacionit në dispozicion në faqet e Qytetit të Shkupit, 14.8% e të anketuarve besojnë se informacioni i nevojshëm nuk mund të gjendet në faqet e Qytetit të Shkupit, **27.8% besojnë se vetëm një pjesë e vogël e informacionit me interes mund të gjendet në këto faqe, ndërsa rreth një e katërta e të anketuarve (26%) besojnë se shumica ose të gjitha informacionet mund të gjenden në faqen e internetit dhe faqet e mediave sociale të Qytetit të Shkupit. Pak më pak se një e treta e të anketuarve (31.5%) kurrë nuk kërkojnë informacion mbi temat lokale në faqen e internetit dhe mediat sociale të Qytetit të Shkupit.**

Grafiku 17. Përceptimet për disponueshmërinë e informacioneve në faqen e internetit dhe mediat sociale të Qytetit të Shkupit, në përqindje.



Të pyetur për disa karakteristika të informacioneve që i shpërndajnë institucionet kompetente për tema me interes. Në pyetjen nëse "informacionet që i shpërndan institucioni" janë të rregullta/të arritshme/ të qarta/të kuptueshme, të anketuarit ishin në gjendje të shprehnin (mos)pajtimin e tyre në shkallën nga 1-5 ku 1 do të thotë "nuk pajtohem aspak" dhe 5 do të thotë "pajtohem plotësisht". **Për sa i përket MMJPH, 43.7% e të anketuarve besojnë se informacioni shumicën e kohës ose pothuajse kurrë nuk është i rregullt; 34.1% nuk** kanë një qëndrim të përcaktuar për çështjen, ndërsa 22.2% pajtohen pjesërisht ose plotësisht me pretendimin se informacionet nga ky institucion janë të rregullta.

Kur bëhet fjalë për rregullsinë e informacioneve të MASH-it, rreth një e katërta e të anketuarve, përkatësisht 26.1%, nuk pajtohen pjesërisht ose plotësisht me pretendimin se informacionet nga ky institucion janë të rregullta. Rreth një e treta ose 32.4% nuk kanë qëndrim të përcaktuar për çështjen, ndërsa **41.5% pajtohen pjesërisht ose plotësisht me pretendimin se Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndan informacione rregullisht.**

Sa i përket rregullsisë së informacioneve të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë, 39.1% e të anketuarve pjesërisht ose plotësisht nuk pajtohen me pretendimin se Ministria e Shëndetësisë publikon rregullisht informacione. Përafërsisht 30% e të anketuarve nuk kanë një pozicion të përcaktuar qartë, **ndërsa 30.2% shtesë konsiderojnë se informacioni publikohet rregullisht.**


Për sa i përket MEMBM-së, pak më shumë se një e treta nuk mendojnë se ministria publikon rregullisht informacione (35.3%), 29.4% nuk kanë një pozicion të përcaktuar **dhe pothuajse një përqindje e barabartë e të anketuarve (35.3%) besojnë se kjo ministri komunikon rregullisht informacionin përkatës me qytetarët.**

Ekziston një ndarje e barabartë në përgjigjet për sa i përket pikëpamjeve në

lidhje me publikimin e rregullt të informacionit nga MBPEJ – 37.5% nuk pajtohen që Ministria publikon rregullisht informacione, një përqindje e barabartë besojnë se informacioni publikohet rregullisht, ndërsa 25% nuk kanë një pozicion të përcaktuar.

Kur bëhet fjalë për Qytetin e Shkupit, më shumë se gjysma e të anketuarve nuk mendojnë se institucioni publikon rregullisht informacione (53.7%), rreth një e pesta - 22.2% nuk kanë një pozicion të përcaktuar, ndërsa rreth një e katërta e përgjigjeve (24.1%) besojnë se informacioni publikohet rregullisht.

Grafiku 18. Perceptimet në lidhje me rregullsinë e publikimit të informacioneve nga një institucion kompetent, vlera mesatare.



Sa i përket disponueshmërisë së informacioneve, 38.9% e të anketuarve nuk konsiderojnë se informacioni që kërkojnë është i disponueshëm nga MMJPH; 29.4% nuk kanë një pozicion të përcaktuar **ndërsa 31.7% konsiderojnë se informacioni i kërkuar është i disponueshëm.**

Pak më shumë se një e katërta e përgjigjeve – 27.5% nuk pajtohen me **pretendimin se informacionet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës janë të disponueshme,** 31% nuk kanë një qëndrim të përcaktuar për pyetjen, ndërsa**41.5% besojnë se informacioni i nevojshëm është i disponueshëm.**

Për sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë, 36.2% nuk pajtohen që Ministria e Shëndetësisë ka informacion në dispozicion, një e treta nuk kanë një qëndrim të përcaktuar për çështjen, **ndërsa 30.7 pjesërisht ose plotësisht pajtohen me pretendimin se informacioni i nevojshëm është i disponueshëm nga Ministria e Shëndetësisë.**


